



---

## **DEKLARATË PRELIMINARE**

**21 nëntor 2017**

### **Konkurrencë e fortë në rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune**

---

#### **PËRMBLEDHJEN EKZEKUTIVE**

---

- Më 19 nëntor u mbajt rundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune në 19 nga 38 komunat e Kosovës përfshirë edhe komunat më të mëdha të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjilanit. Në komunën e Parteshit zgjedhjet për kryetar komune u përsëritën po të njëjtën ditë bazuar në vendimin e Gjykatës Supreme për anulimin e rundit të parë të zgjedhjeve.
- Dita e zgjedhjeve ishte e qetë dhe e rregullt. Vëzhguesit e Misionit Vëzhgues të Zgjedhjeve të Bashkimit Evropian (EU EOM) vizituan 292 qendra të votimit në ditën e zgjedhjeve. Hapja dhe votimi u vlerësuan pozitivisht nga vëzhguesit dhe numërimi kryesisht u zhvillua në mënyrë transparente dhe efikase. Megjithatë, duhet të adresohen disa aspekte të rëndësishme të procesit të votimit dhe numërimit në mënyrë që të përmirësohet më tej procesi në ditën e zgjedhjeve. Të kuptuarit e procedurave të votimit nga votuesit vazhdon të jetë një fushë që ka nevojë të përmirësohet shumë. Votimi me asistencë u kërkuar shpesh dhe jo gjithmonë nga votuesit që nuk ishin në gjendje të votonin në mënyrë të pavarur. Fshehtësia e votës është ndikuar negativisht nga praktika siç është votimi familjar dhe grupor. Përveç kësaj, qasja në objektet e vendvotimeve për personat me aftësi të kufizuara u dëshmuar të jetë e vështirë, ku pak më shumë se gjysma e vendvotimeve të vizituara ishin të qasshme për personat me mundësi të kufizuara të lëvizjes.
- Në fushatë mbizotëroi një atmosferë e qetë. Garuesit patën mundësi të zhvillojnë fushatën lirshëm dhe përgjithësisht u përmbajtën nga përdorimi i gjuhës nxitëse. EU EOM vërejti ngritje të tensionit në Gjakovë dhe Mitrovicë (Jug) ku garuesit e akuzuan njëri tjetrin për metoda të padrejta të fushatës.
- Atmosfera në komunitetet me shumicë serbe të Parteshit dhe Klllokotit ishte e polarizuar por pa incidente. Përfaqësuesit e të dy kandidatëve për kryetar të Parteshit e akuzuan njëri tjetrin për akte të vazhdueshme të blerjes së votave dhe presionit mbi përkrahësit e tyre. Përkundër ankesave për frikësim të përkrahësve të tij nga kandidati për kryetar i Listës Serbe, kandidati i IQ Kllokot Verbovc njoftoi se do t'i bashkohet Listës Serbe pak para zgjedhjeve duke e marrë kështu edhe mbështetjen zyrtare nga përfaqësuesit e saj.
- Mediat audiovizuale gjatë pesë ditëve të fushatës zgjedhore ofruan mbulueshmëri mjaft të balancuar të lajmeve, por në masë të madhe u fokusuan në pesë nga 20 garat për kryetar. Për dallim, mediat audiovizuale të monitoruara organizuan disa debate zgjedhore për të gjitha komunat. Partitë politike kryesore vazhduan të përfitojnë nga zbrazëtitë ligjore që u mundësuan atyre të blejnë numër të pakufizuar të programeve të sponsoruara.

---

\* Ky emërtim nuk e paragjykon qëndrimin për statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe mendimin e GJND-së për shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

EU EOM e publikoi Deklaratën Preliminare të gjetjeve dhe konkluzionet e tij në rundin e parë të votimit i cili u zhvillua me 22 tetor. Kjo Deklaratë i adreson zhvillimet zgjedhore që nga ajo kohë, dhe duhet të lexohet duke e ndërlidhur me Deklaratën e lëshuar pas rundit të parë.

- Përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme dhe të paplotësuara në zgjedhjet për kuvendet komunale të mbajtura me 22 tetor mbetet shumë më e lartë se përqindja në zgjedhjet për kryetar. Shkalla e përgjithshme e fletëvotimeve të pavlefshme për zgjedhjet komunale ishte 8.7 për qind. Ky numër është jashtëzakonisht i lartë në kontekstin evropian, megjithatë ka një rënie krahasuar me zgjedhjet komunale të vitit 2013 kur numri i fletëvotimeve të pavlefshme ishte 10.1 për qind.
- Kutitë e votimit nga rreth 30 për qind e vendvotimeve nga e tërë Kosova është dashur të rinumërohen kryesisht për shkak të punës joprofesionale të Këshillave të Vendvotimeve (KVV). Qendra e Numërimit dhe rezultateve (QNR) rinumëroi 717 kuti të votimit për kuvende komunale, të cilat nuk e kaluan kontrollin e formularëve të rezultateve. Analiza e EU EOM-së bazohet në një mostër të madhe të formularëve të rezultateve. Çka është me rëndësi, dhjetë për qind e formularëve të analizuar treguan mospërputhje prej më shumë se pesë votash për një subjekt politik, ku dallimi më i madh ishte 123 vota.
- Procesi i rinumërimit në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) u zhvillua në prani të vëzhguesve të subjekteve politike, dhe u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si kryesisht transparent. Në përgjithësi, QNR luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e nivelit aq të nevojshëm plotësues të kontrollit të procesit zgjedhor dhe mbetet e domosdoshme për të siguruar të dhëna të sakta nga vendvotimet.
- Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) e ka trajtuar një numër të madh të ankesave dhe apeleve brenda afatit të shkurtër kohor të përcaktuar me ligj, por praktika e panelit për të refuzuar ankesat të cilat ishin paraqitur në mënyrë të rregullt pas mbylljes së vendvotimeve si të parakohshme ka çuar në akumulimin e ankesave pas publikimit të rezultateve dhe në zgjatjen e procesit që çon në certifikimin e rezultateve.
- Gjashtë ankesa kundër rezultateve të rundit të parë të zgjedhjeve për kryetar komune ishin parashtruar në PZAP. Paneli e shqyrtoi një ankesë nga kandidati për kryetar nga Iniciativa Qytetare Narodna Sloga lidhur me blerjen e votave si të bazuar, dhe vendosi të anulojë rezultatet e zgjedhjeve për kryetar të komunës së Parteshit, duke e urdhëruar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të përsërisë këto zgjedhje në tërë komunën.
- Edhe pse QNR rinumëroi 717 kuti votimi për kuvend komunal, në PZAP prapë u parashtruan një numër shumë i madh i ankesave pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal. Prej 505 ankesave të marra PZAP i aprovoi 177, duke urdhëruar KQZ-në të rinumërojë 440 kuti votimi.
- Shtatë nga 17 incidentet që përfshinin edhe një intervenim nga policia dhe prokuroria në tërë Kosovën me 22 tetor janë ende nën hetim. Në Partesh, policia arrestoi dy persona me akuzën se kishin dhënë ryshfet në këmbim të votave në favor të kandidatit të Listës Serbe për kryetar. Në Gjakovë dy persona u arrestuan për akuza të njëjta, por me ndërlidhje më pak të qartë ndërmjet ndihmës së dhënë dhe votave të pritura në favor të një kandidati të caktuar.

---

*Me ftesën e Presidentit të Kosovës të bërë me 25 prill 2017, BE dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (EOM) me 12 shtator për të vëzhguar zgjedhjet komunale dhe për kryetar komune të caktuara për 22 tetor 2017 dhe rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune të datës 19 nëntor 2017. EU EOM udhëhiqet nga Z. Alojz Peterle, deputet i Parlamentit Evropian dhe ish Kryeministër i Republikës së Sllovenisë. Në përgjithësi, EU EOM-i shpërndau në tërë Kosovën 72 vëzhgues nga 25 Shtete Anëtare të BE-së, Norvegjia dhe Zvicra, për të vlerësuar tërë procesin zgjedhor duke e krahasuar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane për zgjedhje demokratike si dhe me ligjet e Kosovës. Misionit iu bashkuan edhe 15 vëzhgues nga përfaqësitë diplomatike të shteteve anëtare të BE-së dhe Norvegjisë, si dhe nga Zyra e BE-së/EUSR për të vëzhguar procesin në ditën e zgjedhjeve. Në ditën e zgjedhjeve, vëzhguesit vizituan 292 vendvotime për të vëzhguar votimin dhe numërimin.*

*Kjo deklaratë preliminare publikohet para përfundimit të procesit zgjedhor. Vlerësimi përfundimtar i zgjedhjeve do të varet, pjesërisht, nga zhvillimi i fazave të mbetura të procesit zgjedhor, veçanërisht nga tabelimi i rezultateve dhe zgjidhja e parashtrësive dhe ankesave të mundshme pas ditës së zgjedhjeve. EU EOM-i do të publikojë një raport përfundimtar që përmban rekomandime të hollësishme, brenda dy muajsh pas përfundimit të procesit zgjedhor. EU EOM-i është i pavarur në gjetjet dhe konkluzionet e tij dhe bazohet në Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve të nënshkruar në selinë e Kombeve të Bashkuara në tetor të vitit 2005.*

---

## **GJETJET PRELIMINARE**

---

### **AMBIENTI POLITIK**

Rundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar komune u mbajt në 19 komuna përfshirë komunat më të mëdha të Prishtinës, Prizrenit, Gjilanit dhe Ferizajt. Dhjetë kandidatë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhjetë nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK), gjashtë nga Vetëvendosje (VV) dhe gjashtë nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) garuan në rundin e dytë. Nisma, Alternativa, Aleanca Kosova e Re (AKR), Lista Serbe dhe Iniciativa Qytetare e Klllokotit e paraqitën nga një kandidat secila. Një kandidat i pavarur mori pjesë në rundin e dytë. Vetëm tetë gra kandiduan për kryetare komune dhe dy ia dolën të kalojnë në rundin e dytë në Gjakovë dhe Mitrovicë (Jug). Në komunën e Parteshit kandidati i Listës Serbe garoi kundër kandidatit të Iniciativës Qytetare Narodna Sloga. Në këtë komunë zgjedhjet komunale u përsëritën bazuar në vendimin e Gjykatës Supreme për të anuluar rundin e parë.

### **DITA E ZGJEDHJEVE**

EU EOM vizitoi 292 vendvotime të ndryshme në ditën e zgjedhjeve. Hapja dhe votimi ishin të qeta dhe të rregullta dhe numërimi kryesisht u zhvillua në mënyrë transparente dhe efikase. Megjithatë, disa aspekte të rëndësishme të procesit zgjedhor lënë hapësirë për përmirësim.

Qasja në objektet e vendvotimeve për persona me aftësi të kufizuara ishte e vështirë, ku pak më shumë se gjysma e vendvotimeve të vizituara ishin plotësisht të qasshme. Aranzhimi i vendvotimeve nuk ishte i përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuara të lëvizjes në më shumë se një të pestën e vendvotimeve të vëzhguara.

Hapja u vëzhguar në 24 vendvotime, të cilat në përgjithësi u hapën me kohë. Në disa raste ishte vërejtur se stafi i vendvotimeve dhe vëzhguesit e subjekteve politike erdhën me vonesë, çka shkaktoi vonesa të vogla. Hapja u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet e vëzhguara.

Votimi u krye në mënyrë të qetë dhe, në përgjithësi, procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në të gjitha vendvotimet, ku stafi i vendvotimeve kryente punën mirë dhe zhvillonte operacionet në mënyrë transparente, me përjashtim të dy vendvotimeve të vizituara. Gratë kishin përfaqësim të ulët në këshillat e vendvotimeve, duke përfaqësuar 26 për qind të stafit zgjedhor në vendvotimet e vëzhguara.

Të kuptuarit e procedurave të votimit nga votuesit vazhdon të jetë një fushë ku duhet të bëhen përmirësime. Votimi me asistencë u kërkua shpesh dhe jo gjithmonë nga votuesit që nuk ishin në gjendje të votonin vet. Më shumë se 10 për qind e votimit me asistencë ishte vërejtur në 43 vendvotime. Fshehtësia e votës është ndikuar negativisht nga praktika siç është votimi familjar dhe grupor, që ishte vërejtur në 15 vendvotime.

Materiale të fushatës janë vërejtur afër 18 vendvotimeve të vizituara. EOM ka marrë disa raporte të mbledhjeve të aktivistëve jashtë qendrave të votimit por prania e policisë parandaloi eskalimin e situatës.

Vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në mbi 90 për qind të vendvotimeve të vizituara dhe të dy kandidatët përkatës ishin të përfaqësuar me vëzhgues në më shumë se 85 për qind të vendvotimeve të vëzhguara.

Numërimi ishte vëzhguar në 29 vendvotime dhe në 25 prej tyre është vlerësuar pozitivisht. Personeli i zgjedhjeve i kreu detyrat e veta në mënyrë transparente dhe, me disa përjashtime të rëndësishme, ishte kompetent. Në dy nga vendvotimet e vizituara procedurat e mbylljes nuk ishin ndjekur si duhet dhe në një vendvotim tjetër përputhja e fletëvotimeve ishte problematike. Në dy vendvotime nuk ishin postuar formularët e rezultateve. Numërimi në një vendvotim në Partesh ishte veçanërisht problematik, ku vëzhguesit e subjekteve politike kishin ndërhyrë në proces dhe në mashtrim të pretenduar. Në këtë vendvotim gjysma e fletëvotimeve të futura në kuti ishin numëruar si të zbrazëta, pa pasur ndonjë shenjë me ngjyrë, por që përmbanin gjurmë.

EU EOM vëzhgoi dorëzimin e materialeve në 23 objekte të Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ). Përkundër disa problemeve të vogla, të gjitha ishin vlerësuar pozitivisht. Lokalet ishin joadekuate në tri KKZ dhe pothuaj gjysma e tyre ishin të mbingarkuara, megjithatë puna e KKZ-ve ishte bërë në mënyrë profesionale. Në një të tretën e KKZ-ve të vizituara stafi i zgjedhjeve u desh të bënte korrigjime të vogla para se të dorëzonte materialet.

Me 19 nëntor, dhoma e kontrollit e Kryeprokurorit raportoi për 23 incidente të hetuara, prej të cilave vetëm një kishte shkuar në procedurë penale. Me 20 nëntor, PZAP mori 10 ankesa lidhur me votimin dhe numërimin.

## **FUSHATA ZGJEDHORE**

Ambienti politik në pjesën më të madhe të Kosovës pas rëndësimit të zgjedhjeve komunale dhe për kryetar komune ishte e qetë. Partitë politike i pranuan rezultatet. Disa kanë ngritur shqetësime rreth numrit të madh të fletëvotimeve të pavlefshme, pasaktësive në listat e votuesve, sjelljes së keqe të stafit zgjedhor gjatë procesit të votimit dhe numërimit, rasteve të blerjes së votës dhe presionit të vazhdueshëm mbi votuesit veçanërisht mbi komunitetet joshumicë.

Fushata vazhdoi menjëherë pas ditës së zgjedhjeve, edhe pse në nivel më të ulët, kryesisht me aktivitete derë më derë dhe kontakte direkte me votuesit në lokacione private dhe duke pasur si cak grupe specifike të votuesve si gratë, të rinjtë dhe sipërmarrësit. Fushata zyrtare u zhvillua në periudhën 13-17 nëntor. Shumica e partive politike zhvilluan fushatë me resurse të kufizuara dhe u dhanë përparësi shpenzimeve në programe të sponsoruara televizive, posterë dhe në organizimin e ngjarje të vogla me votuesit. Garuesit patën mundësi të zhvillojnë fushatën lirshëm dhe përgjithësisht u përmbajtën nga përdorimi i gjuhës nxitëse. EU EOM vërejti tensionim në pak komuna ku rundi i dytë ishte garë e ngushtë, për shembull në Gjakovë dhe në Mitrovicë (Jug) ku garuesit akuzuan njëri tjetrin për presion të paligjshëm mbi votuesit. Kryetari aktual i Mitrovicës (Jug) akuzoi kundërshtaren e tij për metoda të padrejta të fushatës, përkundër faktit se të dy partitë ishin anëtare të koalicionit qeverisës. Vëzhguesit e EU EOM u informuan se përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë si romët, goranët, ashkalinjtë dhe egjiptianët vazhdojnë të jenë subjekt i presionit dhe frikësimit. Në Prishtinë vëzhguesit vërejtën një retorikë politike agresive, ku dy kandidatët drejtuan akuza kundër njëri tjetrit në vend se të diskutonin përmbajtjen e politikave të tyre dhe platformave zgjedhore.

Shumica e subjekteve politike filluan fushatën me ngjarje të vogla dhe organizuan tubime vetëm në ditët e fundit me mesazhe për shëndetësinë, arsimin, papunësinë dhe infrastrukturën lokale. Gratë vazhduan të jenë të nën-përfaqësuar në fushatë. Manifestet zgjedhore të pothuaj të gjitha subjekteve politike kanë ofruar detaje të kufizuara për politikën specifike për inkurajimin e angazhimit më të madh të grave në jetën publike.

Garuesit në përgjithësi respektuan kriteret ligjore për fushatë. Megjithatë, vëzhguesit e EU EOM-së morën raporte të rasteve të izoluar të blerjes së votës në Partesh dhe Gjakovë. EU EOM po ashtu mori raporte për keqpërdorimin e resurseve administrative nga PDK në Klinë dhe nga LDK në Podujevë në një numër të kufizuar të rasteve. Pati pretendime se AAK kishte përdorur lëshimin e certifikatave të veteranëve të financuara me fonde publike për të ndikuar tek votuesit në Klinë, Istog dhe Rahovec.

Atmosfera në komunitetet me shumicë serbe të Parteshit dhe Klllokotit ishte e polarizuar por pa incidente. Përfaqësuesit e IQ Narodna Sloga dhe të Listës Serbe në Partesh e akuzuan njëri tjetrin për akte të vazhdueshme të blerjes së votave dhe presionit mbi përkrahësit e tyre. Përkundër frikësimit kundër Božidar Dejanović-it, kandidat për kryetar nga IQ e Klllokotit/Verbovcit dhe përkrahësve të tij, gjatë gjithë periudhës së fushatës, Dejanović iu bashkua Listës Serbe pak para zgjedhjeve dhe pasi kishte marrë mbështetjen nga përfaqësuesit e tyre.

## **MEDIA**

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), i cili po ashtu e rregullon edhe sjelljen e mediave gjatë zgjedhjeve lokale, aplikohet vetëm gjatë fushatës zgjedhore zyrtare. Në periudhën nga 23 tetori deri me 12 nëntor, transmetuesit e monitoruar ofruan mbulim të kufizuar në lajme të temave lidhur me zgjedhjet, që kryesisht u fokusuan në publikimin dhe komentimin e rezultateve të zgjedhjeve dhe me lidhjen e koalicioneve zgjedhore për rundin e dytë. Disa kanale televizive private filluan të organizojnë debate zgjedhore si dhe intervista të drejtpërdrejta me garuesit e rundit të dytë menjëherë pas ditës së zgjedhjeve në rundin e parë.

Gjatë fushatës zgjedhore pesëditore për rundin e dytë, nga 13 deri me 17 nëntor, televizioni publik *RTK1* dhe mediat audiovizuale private të monitoruara ofruan mbulim mjaft të balancuar dhe neutral të partive politike dhe kandidatëve.<sup>1</sup> Megjithatë, shumica e mbulimit me lajme të zgjedhjeve për kryetar komune, 72 për qind, u fokusua në garën për pesë komuna nga 20.<sup>2</sup> Çka është pozitive, *RTK1* dhe transmetuesit kryesorë privatë u mundësuan kandidatëve të përcjellin mesazhet e tyre duke organizuar disa debate zgjedhore për secilën komunë. Ndërmjet dy rundeve, të gjithë kandidatët morën pjesë në të paktën një deri në disa debate zgjedhore, me përjashtim të garuesve në komunat me shumicë serbe, të cilët nuk morën pjesë në asnjë debat. Përveç kësaj, gjatë fushatës zgjedhore, Vetëvendosje, PDK dhe LDK vazhduan të përfitojnë nga një zbrazëti në ligj që u mundësonte atyre të blejnë sasi të pakufizuar të programeve të sponsoruara.

Komisioni i Pavarur për Media (KPM), gjatë zgjedhjeve të mëhershme, i ndëshkoi disa shkelje të përsëritura të mediave vetëm me vërejtje, pa pasur kurrfarë efekti. Në të vërtetë, të njëjtat shkelje u vërejtën gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e 22 tetorit. Duke i ndërprerë pozitivisht vendimet e tij të mëhershme, me 10 nëntor, KPM gjobiti transmetuesit që kishin shkelur ligjin. Shumica e shkeljeve kishin të bënin me rregullat mbi transmetimin e spoteve politike me pagesë, përfshirë praninë e fëmijëve, dështimin për të ofruar mbulueshmëri të drejtë dhe të balancuar dhe për respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore. KPM vazhdoi të mbikëqyr mbulimin e mediave

<sup>1</sup> EU EOM monitoroi dy kanale televizive publike (RTK1, RTK2) dhe katër kanale televizive private (RTV 21, KTV, Klan Kosova dhe TV Dukagjini) çdo ditë nga 17:00 deri në 01:00, dhe një mostër të mediave të lajmeve online.

<sup>2</sup> Prishtina 24 për qind, Mitrovica (Jugore), dhe Gjakova 14 për qind secila, Gjilani 12 për qind dhe Ferizaj 8 për qind. Gara për kryetar të Prizrenit, komunës së dytë më të madhe të Kosovës, mori vetëm 4 për qind të mbulueshmërisë në lajme në të gjithë transmetuesit e monitoruar.

audiovizuale të fushatës për rundin e dytë të zgjedhjeve, pa vërejtur shkelje të mëdha dhe pa pranuar ankesa.

#### **ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE**

Për rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të komunave, KQZ emëroi anëtarët e KVV-ve duke caktuar numër të barabartë të pozitave kryesuese për subjektet politike që ishin në garë. Sa i përket pozitave të anëtarëve të tjerë të KVV-ve, subjektet politike kishin të drejtë të konfirmojnë ose zëvendësojnë anëtarët e tyre nga rundi i parë. Disa parti politike i zëvendësuan anëtarët e tyre në KVV në përputhje me rrethanat.

Për rundin e dytë të zgjedhjeve periudha e votimit me postë jashtë Kosovës ishte 14 ditë, prej 4 nëntorit deri me 17 nëntor. Pasi që certifikimi i rezultateve të rundit të parë të zgjedhjeve për kryetar komune nga KQZ u stërzgjat dhe u shty për shkak të procesit të ankesave në gjashtë komuna, pjesërisht u ndikua edhe votimi jashtë Kosovës për rundin e dytë. KQZ u detyrua të vonoi tri ditë postimin në faqen e vet të internetit të fletëvotimeve për rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar komune në tri komuna, Obiliq, Kamenicë dhe Istog.

Pas ditës së zgjedhjeve të 22 tetorit, KQZ dhe QNR u fokusuan në tabelimin dhe publikimin e rezultateve si dhe në përgatitjen për rundin e dytë. Procesi i rinumërimit dhe tabelimit të rezultateve ishte shumë i gjatë. Një numër mjaft i lartë, 43 për qind, i kutive të votimit të zgjedhjeve për kuvende komunale u desh të rinumërohen, duke pasqyruar një performancë të dobët nga KVV-të gjatë numërimit të votave dhe gjatë plotësimit të formularëve të rezultateve për zgjedhjet për kuvende komunale. Para rundit të dytë shumica e trajnimeve të vëzhguara për stafin e KVV-ve dhe për ekipit mobile të votimit i kishin si prioritet mësimet e nxjerra dhe mangësitë e vërejtura gjatë rundit të parë. Megjithatë, disa trajnime të KVV-ve u vlerësuan se ishin mjaft të shkurtra dhe formaliste. Në përgjithësi, KQZ nuk ju ofroi informacione kthyesë sistematike KKZ-ve rreth performancës së stafit zgjedhor dhe për të gjitha të metat e zbuluara në nivel të QNR-së.

KQZ e ngarkoi QNR-në që t'i jap prioritet përcaktimit të rezultateve për rundin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune, të cilat u shpallën me 31 tetor dhe u certifikuan me 6 nëntor. Numri i përgjithshëm i votuesve që morën pjesë në rundin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune ishte 833,910, duke paraqitur 44.1 për qind të elektoratit, një rritje përafërsisht prej 3 për qind të pjesëmarrjes së votuesve krahasuar me zgjedhjet parlamentare 2017.<sup>3</sup> Numri i fletëvotimeve të pavlefshme në rundin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune ishte 2.6 për qind.

KQZ publikoi rezultatet e zgjedhjeve për kuvende komunale për të gjitha 38 komunat me 9 nëntor. Të dhënat e detajuara përfshinin një ndarje të rezultateve sipas komunave dhe vendvotimeve, përfshirë edhe votat preferenciale dhe ulëset në kuvendet komunale sipas partive politike. Përqindja e votave të pavlefshme në zgjedhjet për kuvende komunale ishte 8.7 për qind, që ishte më shumë se tri herë më e lartë se përqindja e fletëvotimeve të pavlefshme në zgjedhjet për kryetar komune dhe paraqiste vetëm një përmirësim të vogël krahasuar me përqindjen prej 10.1 për qind në zgjedhjet për kuvend komunal në vitin 2013. Edukimi jo i mjaftueshëm i votuesve dhe kompleksiteti i fletëvotimit për zgjedhjet për kuvend komunal mund të jenë shkak për një numër kaq të lartë të fletëvotimeve të pavlefshme për kuvend komunal.

Procesi i tabelimit në nivelin e QNR-së ishte kompleks dhe i strukturuar qartë, por u zhvillua me ritëm mjaft të ngadalshëm. Me 23 tetor QNR mori materialet zgjedhore nga të gjitha vendvotimet dhe i futi në karantinë 135 kuti votimi fazës së pranimit për shkak të parregullsive. Pesë kuti për zgjedhjet për kryetar komune dhe 22 kuti për zgjedhjet për kuvend komunal u desh të rinumërohen në këtë fazë.

Në fazën e kontrollit, KQZ vendosi të rinumëroi fletëvotimet e vetëm tetë kutive për zgjedhjet për kryetar komune por një numër rekord të lartë prej 695 kutive të zgjedhjeve për kuvend komunal

<sup>3</sup> Në rundin e parë të zgjedhjeve për kryetar komune 2013 pjesëmarrja e votuesve kishte arritur 46.3 për qind.

kryesisht për shkak të mospërputhjeve të vërejtura në numrin e votave të subjekteve politike dhe votave preferenciale për kandidatët. KQZ nuk e publikoi analizën e rezultateve të procesit të rinumërimit. Sipas analizës së EU EOM-së krahasimi i protokolleve para dhe pas 257 rinumërimeve, 55 për qind e tyre treguan mospërputhje të vogla deri në një dallim prej pesë votash për subjektet politike. Një e treta e protokolleve nuk treguan asnjë mospërputhje në votat për subjektet, por vetëm për preferencat e kandidatëve. Është me rëndësi, 10 për qind e formularëve të analizuar treguan mospërputhje prej më shumë se pesë votash për një subjekt politik. Numri më i madh i fletëvotimeve të numëruara gabimisht për një parti politike ishte 123. Përveç kësaj, pas periudhës së ankesave, QNR u desh të rinumëroi 440 kuti votimi për kuvend komunal bazuar në vendimet e PZAP-së. PZAP përfshiu në këto rinumërime edhe 71 kuti, të cilat tashmë ishin rinumëruar nga QNR.

Për të rritur transparencën, KQZ vendosi të urdhërojë rinumërimin e votave për të gjitha subjektet politike dhe të gjithë kandidatët në rastet e mospërputhjeve dhe të vendos të gjithë formularët e rezultateve nga numërimi i parë i votave në vendvotime dhe të gjithë formularët e ri të rezultateve për të gjitha numërimet dhe rinumërimet në QNR në faqen e saj të internetit. Procesi i rinumërimit në QNR u zhvillua në prani të vëzhguesve të subjekteve politike, dhe u vlerësua nga vëzhguesit e EU EOM si kryesisht transparent.

Në përgjithësi, QNR luan një rol të rëndësishëm në ofrimin e nivelit aq të nevojshëm plotësues të kontrollit të procesit zgjedhor dhe mbetet e domosdoshme për të siguruar të dhëna të sakta nga vendvotimet. Edhe pse niveli i transparencës në këtë fazë është rritur, ende ka nevojë për shumë përmirësime lidhur me saktësinë, efikasitetin dhe kontrollin e cilësisë.

#### **ANKESAT DHE APELET**

PZAP e ka trajtuar një numër të madh të ankesave dhe apeleve brenda një afati të shkurtër kohor të përcaktuar me ligj, por praktika e panelit për të refuzuar ankesat të cilat ishin paraqitur në mënyrë të rregullt pas mbylljes së vendvotimeve si të parakohshme ka çuar në akumulimin e ankesave pas publikimit të rezultateve dhe në zgjatjen e procesit që çon në certifikimit të rezultateve.

Pas ditës së zgjedhjeve në rundin e parë me 22 tetor, PZAP refuzoi shumicën prej 263 ankesave lidhur me votimin dhe numërimin të parashtruara në mënyrë të rregullt brenda 24 orëve nga mbyllja e vendvotimeve si të palejueshme, duke i sugjeruar ankuesit që të parashtronjë ankesat pas publikimit të rezultateve përfundimtare. Kjo kishte të bënte edhe me zgjedhjet për kryetar komune edhe me ato për kuvend komunal. PZAP e ndërmori këtë veprim për të shmangur ankesat e shumta lidhur me vendvotimin e njëjtë, si dhe që tu mundësojë ankuesve të përgatisin ankesa të formuluar më mirë dhe të mbledhin më shumë dëshmi. Megjithatë, nuk ka bazë konkrete ligjore për refuzimin e këtyre ankesave si ta palejueshme.

Pas publikimit nga KQZ të rezultateve për zgjedhjet për kryetar komune, gjashtë ankesa u dorëzuan në PZAP brenda afatit prej 24 orësh. Paneli e konsideroi të bazuar një ankesë të kandidatit për kryetar komune nga IQ Narodna Sloga, lidhur me blerjen e votave, dhe vendosi të anuloi rezultatet e zgjedhjeve për kryetar komune në Partesh, duke e urdhëruar KQZ-në të përsërisë këto zgjedhje në tërë komunën. Kandidati për kryetar komune i Listës Serbe u ankua në Gjykatën Supreme, e cila e konfirmoi vendimin e PZAP-së më 7 nëntor.

Pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal, në PZAP u parashtruan 505 ankesa, të cilat ata duhej t'i zgjidhnin brenda 72 orësh. Për shkak të kohës së shkurtër, paneli nuk mundet të zhvillojë hetime gjithëpërfshirëse në qindra raste. PZAP aprovoi 177 prej 505 ankesave, duke e urdhëruar KQZ-në të rinumërojë 440 kuti votimi, dhe refuzoi 268 ankesa si të pabazuara,

kryesisht për mungesë të dëshmive<sup>4</sup>. Një ankesë nuk u lejua, dy ishin refuzuar si të parashtruara pas afatit dhe 47 si të parregullta, që nuk i plotësonin kriteret formale.

### **KONTESTET ZGJEDHORE**

Që nga data 22 tetor në tërë territorin e Kosovës janë ende nën hetime shtatë nga 17 incidente duke përfshirë edhe një intervenim nga policia dhe prokuroria si dhe disa incidente që janë raportuar pak para zgjedhjeve. Shumica e këtyre kishin të bënin me krime të mundshme zgjedhore përfshirë dhënien ose marrjen e ryshfetit në lidhje me votimin, keqpërdorimin e të drejtës për të votuar, pengimin e procesit të votimit, shkeljen e fshehtësisë së votës dhe asgjësimin e dokumenteve të votimit. Të dyshuarit shpesh janë mbajtur për 48 orë me urdhër të prokurorit e pastaj janë liruar në procedurë të rregullt. Disa votues që kishin fotografuar fletëvotimet e tyre u morën në pyetje dhe u ndaluan deri në 48 orë për shkak të hetimeve nën dyshimit se kanë marrë ryshfet. Kjo është masë e rëndë, por mund të ndihmojë për të dekurajuar dhe zvogëluar përpjekjet e ardhshme për blerje të votës. Në një rast në Dragash, vozitësi i ekipit mobil i cili dyshohej për mbushjen e një kutie mobile të votimit u urdhërua të mbahet për 30 ditë deri me 21 nëntor.

Në Partesh, një rast që lidhje me ryshfet që përfshinte kandidatën për kryetar nga Lista Serbe është ende në hetim. Me 21 tetor policia në Gjilan arrestoi dy persona në akuzën se kanë dhënë ryshfet në këmbim të votave në favor të kandidatit të Listës Serbe. Të paraburgosurit ishin vënë nën arrest shtëpiak. Gjatë seancës dëgjimore, një grup prej 30 përkrahësish të kandidatit të Listës Serbe hyn në objektin ku ishte zyra e prokurorit. Pasi arritën Forcat Speciale të PK-së, përkrahësit e Listës Serbe u larguan nga objekti dhe seanca dëgjimore vazhdoi. Ndryshe nga dy persona të tjerë të përfshirë në këtë rast, kandidati nuk u vu nën arrest shtëpiak. Një rast tjetër lidhur me pretendimet kundër Listës Serbe për blerje të votave lidhur me zgjedhjet për kuvendet komunale po ashtu ka qenë nën hetim nga prokurori. Dëshmia në rastin lidhur me zgjedhjet për kryetar komune në Partesh ishte veçanërisht bindëse. Në një rast tjetër të arrestimeve nën dyshimin për blerje të votave në Gjakovë përmes shpërndarjes së pakove ushqimore, lidhja ndërmjet shpërndarjes së ndihmës dhe votave për një kandidat të caktuar nuk është shumë e qartë, veçanërisht për publikun.

### **SHOQËRIA CIVILE DHE VËZHguesIT VENDORË**

Demokracia në Veprim (DnV), një koalicion i OJQ-ve, i cili është grupi kryesor vendor i vëzhguesve të zgjedhjeve ka monitoruar vetëm periudhën e fushatës zyrtare me një numër të reduktuar të vëzhguesve afatgjatë krahasuar me rundin e parë dhe ka dalur me një deklaratë pas përfundimit të fushatës. Me 19 nëntor, DnV shpërndau 1,784 vëzhgues në të gjitha vendvotimet e 20 komunave ku u zhvilluan zgjedhjet. Pak pas mbylljes së vendvotimeve në natën e zgjedhjeve ata paraqitën rezultatet e hershme të zgjedhjeve bazuar në vëzhgimin e tyre.

Me resurse të kufizuara, organizatat e shoqërisë civile janë përpjekur të zhvillojnë aktivitete për edukimin e votuesve e nganjëherë kanë mundur dialogun ndërmjet kandidatëve dhe votuesve. OJQ-të si Handikos kanë ngritur shqetësime për mundësinë e qasjes në lokacionet e votimit për personat me aftësi të kufizuara dhe OJQ Roma in Action ka shpërndarë vëzhgues në ditën e zgjedhjeve.

---

<sup>4</sup>Shumica e ankesave të aprovuara ofronin dëshmi për mospërputhjet ndërmjet formularëve të rezultateve dhe rezultateve të publikuara në faqen e internetit të KQZ-së. Një grup tjetër i ankesave të aprovuara ofronin si dëshmi deklaratat me shkrim të një numri të caktuar votuesish që konfirmonin se kanë votuar për një kandidat, derisa rezultatet e publikuara nuk i tregonin këto vota për këtë kandidat. E një grup tjetër i ankesave ofronin si dëshmi deklaratat e anëtarëve të KVV-së që ia konfirmonin kandidatëve se ata kishin marrë më shumë vota pas numërimit në Vendvotim se sa që kishin në rezultatet e publikuara.